



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 720/6 Prot

Tiranë, më 30.12.2020

**V E N D I M**

Nr.229, datë 30.12.2020

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së pretendimeve të punonjësës së Bashkisë Kolonjë, \*\*\*\*\*, për parregullsi të ndryshme të kryera ndaj saj, në shkelje të legjislacionit të shërbimit civil.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90 të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të verifikimit të pretendimeve të parashtruara prej punonjësës \*\*\*\*\*,

**Vërejtje:**

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, janë paraqitur dy ankesa, protokolluar me nr. 720 prot., datë 23.09.2020, nr. 720/3 prot., datë 28.10.2020, dhe nr. 720/4 prot., datë 02.11.2020, prej punonjësës \*\*\*\*\*, në të cilat janë parashtruar pretendimet të ndryshme për parregullsi të kryera gjatë dhënies së masës disiplinore me vendimin nr. 54 (37/4 prot.), datë 31.08.2020, “Vendim”, të Komisionit të Disiplinës, “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në 2 vjet”, e më pas shoqëruar me lirim nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit të institucionit, (në zbatim të vendimit të Komisionerit nr. 123 (514/3 prot.) datë 15.10.2020).

Në përmbajtjen e kërkesës së saj, nëpunësja \*\*\*\*\* parashtron se është nëpunëse civile dhe aktualisht kryen detyrën e “Specialistit One Stop Shop”, në Bashkinë Kolonjë, pozicion në të cilin është transferuar në mënyrë të parregullt nga Njësia Përgjegjëse e institucionit.

Gjithashtu, ankuesja, ka parashtuar se zbatimi i vendimit të Komisionerit nr. 123 (514/3 prot.) datë 15.10.2020, bazuar në të cilin është revokuar *Urdhëri nr. 32 (nr. 1823 prot.) datë 18.05.2020, i Titullarit “Për Transferimin e përhershëm të \*\*\*\*\*”*, nuk është kuptuar drejt dhe Njësia përgjegjëse e Bashkisë Kolonjë, nuk e ka kaluar çështjen për rishqyrtim në Komisionin e Ristrukturimit, si është dhënë në rekomandim, por ka urdhëruar direkt, lirim nga detyra.

Në të njëjtën kohë, pretendohet se gjatë kësaj periudhe ndaj saj, është zhvilluar një procedurë disiplinore, në përfundim të të cilës Komisioni i Disiplinës me vendimin e tij nr.54 (37/4 prot.), datë 31.08.2020, ka dhënë masën disiplinore *“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në 2 vjet”*, si rezultat i mungesave të vazhdueshme dhe të pajustificuara në punë.

Për verifikimin e pretendimeve të mësipërme dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera, Komisioneri ka kryer hetim administrativ, nga ku ka rezultuar si më poshtë:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit civil, ka shqyrtuar pak kohë më parë, rastin punonjëses \*\*\*\*\*, në lidhje me ligjshmërinë e transferimit të përhershëm të saj, për shkak të ristrukturimit të institucionit dhe me vendimin nr. 123 (514/3 prot.) datë 15.10.2020 *“Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë së informacionit të dërguar nëpërmjet kërkesës së punonjëses së Bashkisë Kolonjë, \*\*\*\*\*, për parregullsi të pretenduara se janë kryer në procedurën e transferimit të përhershëm të saj, për shkak të ristrukturimit të institucionit”*, ka kërkuar nga Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Kolonjë, të anulojë aktin administrativ nr. 32 (1823 prot.) datë 18.05.2020, *“Për transferimin e përhershëm të \*\*\*\*\*”* si një akt i paligjshëm dhe të kthjejë për rishqyrtim të pjeshëm propozimin e Komisionit të Ristrukturimit (*relacion nr. 1798 prot., datë 15.05.2020*), në pikën ku trajtohet rasti i punonjëses \*\*\*\*\*, duke vepruar sipas vërejtjeve në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.

Kjo për faktin se pozicioni *“Specialist i One Stop Shop”*, në të cilin është propozuar kalimi i saj nga Komisioni i Ristrukturimit, rezulton të jetë një pozicion i cili nuk mund të konsiderohet si pjesë e shërbimit civil, pasi për nga natyra e punës ky pozicion ka karakter të shërbimit publik të drejtpërdrejtë, që në kuptim të përkufizimit që i bën pika *“dh”* e nenit 4, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, është *“Njësi publike direkte të shërbimit”*, që funksionon në bazë të ligjit nr. 13/2016 datë 18.02.2016 *“Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”*.

Në përfundim të veprimeve për zbatimin e vendimit nr. 123 (514/3 prot.) datë 15.10.2020, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Njësia përgjegjëse e Bashkisë Kolonjë, me shkresën e saj nr. 4923/1 datë 05.11.2020 *“Shkresë përcjellëse”*, ka dërguar gjithë praktikën dokumentare që materializojnë këto veprime, ku përfshihen:

- Akti nr. 5001 datë 21.10.2020, me të cilin është njoftuar punonjësja për procedurën e rishqyrtimit sipas urdhërimit në Vendimin e Komisionerit;
- Procesverbali i mbledhjes së datës 23.10.2020, të Komisionit të Ristrukturimit, në të cilën është rishqyrtuar mundësia e sitemimit të nëpunëses \*\*\*\*\* , në përfundim të të cilës, në shterim të mundësisë për sistemim, për mungesë pozicionesh të lira, të përshtatshme me kualifikimin arsimor të saj, me aktin nr. 5059 datë 23.10.2020 është vendosur, përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për nëpunësen \*\*\*\*\* , nga pozicioni “*Specialist për Marrëdhënien me Publikun, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore*”;
- Akti nr. 72 (5082 prot.,) datë 26.10.2020 i njësisë përgjegjëse të Bashkisë Kolonjë “*Për lirim nga shërbimi civil dhe përfundimin e marrëdhënieve të punës me \*\*\*\*\**”.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së dokumentacionit të përshkruar më sipër, arrihet në përfundimin se ndryshe nga sa pretendon kërkuesja, nga ana e njësisë përgjegjëse dhe Komisioni i Ristrukturimit, është vepruar drejt, në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil dhe vendimin nr. 123 (514/3 prot.,) datë 15.10.2020 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, prandaj pretendimi i saj në lidhje me këtë problem nuk mund konsiderohet i drejtë.

Në lidhje me pretendimin tjetër të kërkueses \*\*\*\*\* , se në kohën që kryente detyrën “*Specialist i One Stop Shop*” në Bashkinë Kolonjë, në ngarkim të saj është zhvilluar një procedurë disiplinore, me motivacion për mungesa të vazhdueshme dhe të pajustificuara në punë, në përfundim të të cilës Komisioni i Disiplinës me vendimin e tij nr. 54 (37/4 prot.,) datë 31.08.2020, ka dhënë masën disiplinore “*Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në 2 vjet*”, arsyetojmë si vijon:

Duke qenë se pozicioni i punës “*Specialist i One Stop Shop*”, nuk përfshihet në shërbimin civil, marrëdhëniet e punës së punonjësve të këtyre njësive, rregullohen sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e Punës, kështu që nisur nga përmbajtja e pikës 1, të nenit 14, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, shqyrtimi i kërkesës për vlerësimin e ligjshmërisë së këtyre procedurave administrative, nuk përfshihet në juridiksionin material të çështjeve që mund të trajtohen prej Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Nisur nga fakti që kjo çështje disiplinore, pavarësisht se pozicioni i punës nuk është pjesë e shërbimit civil, është shqyrtuar nga Komisioni i Disiplinës dhe janë zbatuar procedura të ngjashme me legjislacionin e shërbimit civil, nuk e bëjnë këtë veprim administrativ të paligjshëm, sepse respektimi i rregullave të procedurës së shërbimit civil, ka siguruar një nivel të mirë të respektimit të të drejtave të nëpunëses në fjalë, që lidhen me të drejtën e saj të njoftimit, njohjes me provat, mbrojtjes e dëgjimit të pretendimeve, ankimit, etj.

Gjatë zhvillimit të hetimit administrativ në fjalë, u konstatua gjithashtu se nëpunësi në fjalë, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Korçë, me kërkesë padi e para, me objekt shfuqizimin e aktit administrativ vendimin nr. 54 (37/4 prot.), datë 31.08.2020, “Vendim”, të Komisionit të Disiplinës, për dhënien e masës disiplinore, “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në 2 vjet” dhe e dyta shfuqizimin tërësisht të aktit nr. 72 (5082 prot.) datë 26.10.2020 “Për lirim nga shërbimi civil dhe përfundimin e marrëdhënieve të punës me \*\*\*\*\*”, duke vendosur rikthim në vendin e punës dhe pagimin e pagës deri në rikthimin në pozicionin e mëprshëm të punës.

Nisur nga sa më sipër, bazuar në parimin e sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr.8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, sipas të cilit institucionet e tjera nuk mund të trajtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësojmë se në këtë rast, nuk duhet të vijojë më tej hetimi administrativ, pasi mosmarrëveshja do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata, e cila do të vendosë edhe për zgjidhjen e pasojave të aktit.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e hetimit administrativ filluar në bazë të informacionit të punonjësës \*\*\*\*\* , të regjistruar me nr. 720 prot., datë 23.09.2020, nr. 720/3 prot., datë 28.10.2020, nr. 720/4 prot., datë 02.11.2020, në lidhje me procedurën e masës disiplinore dhe largimin nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit dhe arkivimit e çështjes, pasi çështja do të zgjidhet në mënyrë përfundimtare nga Gjykata.
2. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Kolonjë dhe nëpunësja \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**